



## TEKFIRI I MUSHRIKVE

Thotë shejh Ibrahim el Bikaj (885 h) Allahu e mëshiroftë në shpjegimin e tij: "Nuk ka asnjë pejgamber që të ket ardhur vetëm se me tekfirin e mushrikëve, ashtu siç ka bërë me dije në këtë dhe i dërguar i Allahut salallahu alejhi ue selam me fjalën e tij: "Pejgamberët janë vëllezër prej një babe kurse nënat e tyre janë të ndryshme dhe e feja e tyre është një." (Nadhmu durari 6/267) Ka thënë El-Hatib El-

Bagdadi (392- 463 Hixhri): "Ebu Seleme ka thënë: "Kush nuk dëshmon për kufrin e kafirit ai vet bëhet kafir." (Libri: Tarihu Bagdad)

Ebu Seleme, autori i shkrimit të sipërm ,ka jetuar në kohën më të mirë. Dhe ka vdekur në vitin 246 Hixhrit Allahu e mëshiroft. Emri i tij Ebu Seleme ibn Shib en-Nejsaburi en-Nesa'i, muhadith dhe banor i Mekkës dhe Imam i njohur. Imam El-Mizzi transmeton se Ebu Seleme ka qënë ithtar i të vërtetës dhe i devotshëm, Ebu –Ne'im thotë se ka qënë i saktë , kurse Ibn Hibban e përmend në libër si Besnik. Gjithashtu e ka lavdëruar edhe Imam Muslimi, Ebu Hatimi dhe gjithë njohësit e "Sunenit" Shumica e e imamve e kanë transmetuar fetvan e Ebu Selemes rreth tekfirit të atij i cili nuk e bën tekfir kafirin ,sikur janë: Imam El Mizzi (742 Hixhri) në "Tehzibul-Kemal" , Ibn-Haxher el-Askalani (852 Hixhri) në "Et-Tehzibu", Ibni-'Asakir (571 Hixhri) në punimin e tij "Tarihu", gjithashtu Ibnud-Dimjati (705 Hixhri) në librin e tij "El-Mustefad" si shtojcë e veprës "Tarihu Bagdad".

Ka thënë Ibnul Vezir në veprën "Er-Revd El-Basim"(2/508): "Nuk ka dyshim se ai që dyshon te kufri i adhuruesit të gurit/putave është obligim të bëhet tekfir, dhe ai që nuk e bën këtë tekfir ka bë kufër, dhe nuk ka pengesa në këtë sepse ky kufr është i qartë në fenë Islame."

Ka thënë El-Bika'i në "Mesre'a Et-Tesuf" (1/253): "...Dhe askush të mos nxitoj dhe të thotë unë kam marur qendrimin e drejt dhe kam zgjedhur heshtjen, nuk pohoj e as nuk mohoj. Kush i thotë këto fjalë ka bë kufr. Për arsye se kafiri e mohon atë që njihet qartë në fenë Islame, dhe kush dyshon të kufri i këtij ka bërë mosbesim në Allahun.

Në lidhje me këtë Ibnul-Mukri në "Muhtesar er-revdah" ka thënë kush dyshon në kufrin e Jehudve, Krishterve dhe pasuesve Ibn Arabiut ai është kafir. El Kadi 'Ijad në vëllimin e dytë në pjesën e katërt të Librit "E-Shifa" transmeton ixhman rreth kufrit të atij që nuk i bën tekfir Krishterët , Jehudët dhe çdonjërit që zgjedh fe tjetër pos fesë Islame apo që dyshon apo nguron dhe nuk i bën tekfir ata. El Kadi Ebu –Bekr thotë kjo ndodh për arsye se (Kur'ani dhe

Sunneti) dhe ixhmaja janë pajtuar rreth kufrit të tyre, dhe kush ndalet në tekfirin e tyre ka përgenjështuar tekstet dhe dyshimi në tekstet e qarta nuk ndodh vetëm se prej kafirit. Fund. Dhe ka thënë në “Nidhmu ed-durer”(8/267)

”Mallkimi i Allahut qoftë mbi Ibn Arabiun dhe Ibnul-Faridindhe atë që e pason dhe dyshon në kufirin e tyre dhe nuk i mallkon pasi që i është bërëi qartë dalaleti që kanë perhapur nëpër shtete dhe kanë shkatëruar shumë rob të Allahut .”

Ka thënë En-Neveviu në “Revdatu-t-Talibin”：“Kush nuk e bën tekfir atë që zgjedh fe tjetër pos fesë Islame si rasti i Krishterëve apo dyshon në tekfirin e tyre ose e konsideron medhhebin e tyre të saktë. Ai vet është kafir edhe nëse pas kësaj shfaq islamin dhe e beson si fe të vetme të pranuar te Allahu.”

Sufjan ibn Ujejne (198 Hixhri) një nga dijetarët e mëdhenj të hadithit ka thënë: “Kur’ani është fjala e Allahut të Madhëruar. Kush thotë ai është i krijuar konsiderohet kafir e kush dyshon në kufirin e tij ai vet është kafir.

(Transmeton djali i Imam Ahmedit Abdullahu në librin e tij es-Sunne me numër 25, me zinxhir transmetimit sakt). Fjalim të njejt transmetohet edhe prej Ebu-Hajthemeh Musab ibn Se’id el-Musajfija, në shpjegimin e librit “Usul el itkad ehli-sunneti vel-xhema’ah”(2/256 numër 430) prej imamit El-Hafi Ebu kasim Hibetullah el-Laleka’i (418 Hixhri).

Gjithashtu në Sunnenin e Lalek’ait (2/250-numër 412) thuhet se Ebu-Bekr b.Ajjash el-Mukri’ (194 Hixhri) është pyetur rreth atij i cili thotë se Kur’ani është i krijuar, dhe ka thënë:”Kush thotë kështu është kafir ,dhe kush nuk i thotë këtij kafir edhe ai vet është kafir.”(Transmetimi i zinxhirit është i besushëm)

Në lidhje me këtë Ebu Seleme ibn Shebib en-Nejsaburi ,muhadith në Kufe.Ibn Haxheri në Tehzibu 2/303 thotë:”Davud ibn Husejn el Bejheki ka thënë :”Më ka ardhur lajmi se Hulvani ka thënë:”Nuk e bëj tekfir në çështjen e meseles Kur’anit.Thotë Davudi:”E pyeta Ebu Selemen për Hulvanin dhe më tha:”Duhet të hidhet në mbeturina (kjo thënie) ,kush nuk dëshmon për kufirin e kafirit ai vet është kafir.”(Thënie e transmeton Hatib el Bagdadi në tarihu Bagdad 7/365).

Përgjigja e Imam Ahmedit ,Allahu e mëshiroft ,në risalen Musredu b.Musrehd el Basri në lidhje me pyetjen për krijimin e Kur’anit qëndron:”Eshtë fjala e Allahut e nuk është i krijuar dhe kush thotë se është i krijuar ai është kafir në Allahun. Dhe ai i cili nuk e bën këtë tekfir është gjithashtu kafir.”(Tabaqatul –hnabile nga Ebu-Ja’la el-Hanbeli,1/315.) Thotë Imam Ahmed ibn Hanbeli:”Kur’ani është fjala e Allahut dhe nuk është i krijuar.Kush thotë se Kur’ani është i

krijuar ai është Xhehmij-kafir. Dhe kush thotë Kurani është fjala e Allahut ,por ndalet dhe nuk thotë që ai (Kur'ani) as nuk është i krijuar, kjo dëshmi është më e keqe se thënia e parë (pra duhet të thotë: Kur'ani është fjala e Allahut dhe nuk është i krijuar).E kush thotë se shqiptimi jonë dhe leximi mësimittë Kur'anit është i krijuar kurse Kur'ani është fjala e Allahut ,gjithashtu është Xhehmij. Dhe kush nuk i bën tekfir këtë popull (xhehmijve) është sikur ata.”El Akideh” e imam Ahmed ibn Hanbel transmetimi “Abdus el-Atari e botuar në veprën “El-Akideh me transmetim të Ebu-Bekr el-Khalalla,faqe 79.e botuar nga Darul-kutejbe .Damask viti 1408 Hixhrij 1988 te kalendarit diellor. Gjithashtu imam Ahmedi thotë:“Ajo e cila është në “Levhil-mahfudh”dhe në Kuran dhe ajo çfarë njerëzit e mësojn (në Kur'an) –gjithsesi në çfarëdo forme të shkruhet – është fjala e Allahut dhe nuk është e krijuar. Dhe kush thotë se është e krijuar ai është kafir në Allahun e Madhëruar.Dhe kush nuk e bën këtë Tekfir gjithashtu edhe ai është kafir.-“El-‘Aqideh” nga imam Ahmed ibn Hanbeli me transmetim të Mused ibn Musrehed ,me botim dhe transmetim El-Khallala,faqe 60 Salih

(I biri i Ahmed ibn Hanbal) thotë se i ati ka thënë: " Xhehmijet përbëhen nga tre sekte. Një sekt thotë se:“Kur'ani është i krijuar”, një tjetër thotë që:“Eshtë fjala e Allahut dhe heshtin”dhe tjetri thotë që:“Recitimi ynë i Kur'anit është i krijuar”. Nuk duhet të falemi pas atyre që heshtin e as pas atyre që thonë se Kur'ani është i krijuar". Ahmed Ed-Dawraki ka thënë se ai pyeti Ahmed ibn Hanbal rreth atij që thotë se:“Recitimi im i Kur'anit është i krijuar”ai iu përgjigj: "Kjo është më djallëzore se thënia e xhehmijve . Kush thotë kështu thotë se Xhibriili foli dhe erdhi tek Rrasuli me ç'është e krijuar (me Kur'anin)".Gjithë këto janë xhehmij kafira ,prej tyre kërkohet pendimi ,ose pendohen ose vriten.”-El-Aqideh” nga imam Ahmed ibn Hanbeli faqe 61.

Thotë djali i imam Ahmedit Abdullahu në Librin “Es-Sunneh”:"Kam dëgjuar babain tim Allahu e mëshiroftë duke thënë:”Kush thotë Kur'ani është i krijuar ai është kafir tek të gjithë ne, për shkak se Kurani është dituria e Allahut Azevexhel dhe në atë janë emrat e Tij .” Ibnul Kajjim në librin e tij përmend “l'lamur –muvek'in” se Imam Ahmedi është pyetur rreth atyre që thonë Kurani është Krijuar se a është thënësi i kësaj fjale kafir?Ai është përgjigjur:”Po pasha Allahun është!”

Imam Ahmedi e ka konsideruar darul kufr (shtet i kufrit) atë shtet i cili ka besuar se Kur'ani është i krijuar apo që kanë vepruar bidate tëndryshme të cilat të nxjerin prej fesë. Imam Ahmedi tha se ky shtet është shtet i kufrit.Ka thënë Ebu-Bekr el-Khalal:“Nëse në një shtet shfaqet besimi se Kurani është i krijuar dhe bidati i kaderit , atëher konsiderohet shtet i kufrit”. Imam Ahmedi nuk është i vetmi me këtë besim ,Imam El-Laleka'u në shpjegimin “Usulu l'tiqadi ehli-sunneti vel-Xheme'ah” ka numëruar rreth 550 pasues që e kanë pasuar dhe të gjithë kanë thënë :”Kur'ani është fjala e Allahut dhe nuk është i krijuar ,dhe kush thotë se është i Krijuar ai është kafir”.Dhe ka thënë:“Sikur të transmetoja fjalimin e muhadithinëve numri i tyre do të

tejkalonte përmbi 1000 ,por unë i kam fshirë disa zinxhira të transmetimit për arsye të shkurtimit .”

Ka thënë imam Es-Sixhzi në risalen (shkrimin) e tij si përgjije ndaj atyre që mohojn vetëm një harf/shkronjë dhe fjalën e Allahut :“Janë pajtuar të gjithë pasuesit e Sunnetit se Kurani nuk është i krijuar dhe ai i cili thotë se është i krijuar është kafir.Dhe shumica kanë thënë është kafir me kufrin I cili nxjer prej fes Islame”.

Ibnul –Mukri në “Er-Revdah” ,duke transmetuar prej librit”El-l’lam bi-qawati”il-islam“thotë:“Ai i cili nuk e bën tekfir Ibn Arabiun dhe pasuesit e tij është i njejt si ai që nuk i bën tekfir Jehudët dhe Krishterët.”Libri:“El-l’lam bi qawati’il-islam” nga Ibn Haxher el-Hejtemiju ,faqe 379.Botimi:Darul-ma’rifeh.

Ka thënë Shejhul Islam Ibn Tejmije Allahu e mëshiroft në "El-lqna" : “Ai që kërkon ndihmë nga i vdekuri e dhe nëse ai i vdekuri ka qenë Halif i drejt ,ky person që i lutet të vdekurit është Kafir dhe secili që dyshon në kufrin e tij është kafir." Libri "El-Gunjeh", faqe 73.

Thotë Shejhul-islam Ibn-Tejmije,Allahu e mëshiroft:”Kush i fyen sahabet apo ndonjërin prej tyreapo mer pjesë në fyerjen e tyre ose thotë se Aliu është Zot apo Pejgamber apo thotë Xhibrili ka gabuar, nuk ka dyshim në kufrin e tij ,dhe gjithashtu nuk ka dyshin në kufrin e atij që ndalet në Tekfirin e këtij.”-Es-Sariumul-meslul,faqe 591 Botimi:Darul-Dxhejl.

Gjthashtu shejhul-Islam Ibn-Tejmije ka thënë:”Kush i lutet Aliut ka bë kufër ,edhe ai i cili dyshon në kufrin e tij ka bë kufër.”Er-risaletus-senijeh Dhe ka thënë shejhul-Islam Ibn-Tejmije:”Ndërsa sa i përket atij që thotë dhe beson se Sahabet kanë dalur prej fesë pas vdekjes së Pejgamberit alejhi selam dhe se vetëm disa kanë mbetur në fe dhe të tjerët janë bër fasika. Nuk ka dyshim në kufrin e këtij me këtë thënie,për arsye se ka përgenjështuar atë me të cilën ka ardhur Ku’rani duke e ditur qart se Allahu shumë vende i lavdëron sahabet dhe është i kënaqur me ta dhe kush dyshon në kufrin e tij gjithashtu është kafir .(Es-sarimul-meslul,faqe 591 Botimi:Darul-xhejl.)

Dhe gjithashtu shejhu Allahu e mëshiroft ,në një vend tjetër e cek se Muhammed ibn Suhnun ka thënë:Muhamed Bin Suhnun, një prej imamëve nga medhehebi i Malikut, i cili ka jetuar afër kohës së tij, thotë: “Dijetarët janë të pajtimit se fyesi ndaj Pejgamberit s.a.v.s, i cili e përqesh Atë s.a.v.s, ai është kafir. Pra mbi atë vazhdon kërcënimi me dënim të Allahut. Dispozita e tij në ummet është vrasja dhe ai i cili dyshon në kufrin dhe dënimin e tij, bën kufër gjithashtu”. (shih:Esh-shefa bi ta’rifi huquqil –mustafa nga Kadi’ljadi,2/215.)

Pasi dihet që ai i cili e nënçmon Pejgamberi alejhi selam është kafir pa asnjë dyshim,dhe të gjithë dijetarët janë pajtuar rreth kufrit të tijdhe janë pajtuar rreth kufrit të atij i cili nuk e bën

këtë tekfir,atëher çfar duhet të themi për atë i cili e fyen Allahun e Madhëruar,Zotin e Qiejve dhe Tokës,dhe ai i cili ia drejton ibadetin dikujt tjetër pos Allahut?!Kurse shirku padyshim është fyerje ndaj Allahut Tebareke ve te'ala,dhe shirku është padrejtsia më e madhe dhe mekati më i madh. Shejh Muhammed bin Abdulvehhab,Allahu e mëshiroft ,në lidhje me këtë ka thënë:"Nëse dikush e ngrit një person në shkallen e Pejgamberve ashtu siç vepruan me Musejleme Kedhabin, ai ka bërë kufër. Pasuria dhe gjaku i tij janë Hallall dhe nuk do ti bëj dobi shqiptimi i shehadetit e as namazi,e atëher çfarë të themi për atë i cili e ngrit Shemsiun apo Jusufin apo Sahabet ose Pejgamberët në shkallë të njejtë me Allahun!"Kështu Allahu ua vulos zemrat atyre që nuk din."(Er-Rum:59.)

(Risala:Keshfu shubuhat fit-tevhid.

Shih Iben Tejmijja se si arsyetuesin dhe dyshuesin e shpalle kafir - Thotë Sheikhul Islam Ibn Tejmijje (Allahu e mëshiroftë):"Besimi se Zoti është i mishëruar në ndonjë individ, siç thonë krishterët për Isën (alejhis selam), poashtu dhe fanatikët të cilët po në të njejtën mënyrë e shpallin Aliun (Allahu qoftë i kënaqur me të)... Të gjitha këto fjalë janë Kufër në anën e jashtme(Dhahir) dhe të brendshme (batin), dhe rreth kësaj pajtohen të gjithë muslimanët. Ai i cili dyshon në mosbesimin e këtyre fanatikëve,pasi që ta kuptojnë fjalën dhe qëndrimin e tyre, vetë del nga feja dhe bëhet kafir si ata që dyshojnë në Kufrin e krishterëve,jehudëve dhe mushrikëve të tjerë..."

(Mexhmu'ul Fetava, 2/367-368)

Shejhul-Islam ibn Tejmijje duke folur për Druzët thotë:"Rreth kufri të tyre janë pajtuar gjithë Muslimanët,poashtu,edhe ai që dyshon kufrin e tyre është kafir sikur ata.Ata Druzët nuk janë as shkallën e ehlu kitabve e as mushrikve,por jan Kafira më të këqij dhe nuk lejohet të hahet ushqimi i tyre ."

(Mexhmu'ul-fetava,35/98)

Thotë El-Kadi 'Ijad në librin e tij "Esh-Shifa:."Dhe ne e bëjm tekfir atë i cili nuk e bën tekfir atë që zgjedh fe tjetër pos fes Islame ,apo ndalet dhe dyshon në kufrin e tyre ,ose e sheh rrugën e tyre të saktë edhe nëse pas kësaj ai e shfaq Islamin dhe e beson Islamin si fe të vetme të pranuar ai prap është kafir."(Kitab esh-Shifa,2/610) Ndoshta disa do të thonë kjo vlen vetëm për atë i cili nuk i bën tekfir Jehudët dhe Krishterët,por jo asesi kjo vlen për çdonjërin i cili mer fe tjetër pos fesë Islame siç është edhe murtedi dhe të tjerë.Dhe ka thënë Muhammed ibn Suhnun:"Janë pajtuar dijetarët se ai i cili e fyen Pejgamberin alejhi selam është Kafir i cili meriton denim dhe hukmi i tij tek ummeti është vrasja dhe kush dyshon kufrin dhe dënimin e tij është kafir gjithashtu."

Gjithashtu El-Kadi 'Ijad thotë:"Të njejtën gjë e kanë thënë Xhahizi dhe Sumame se shumica e pasuesve të thjesht prej krishterve si: grat,femijët dhe shumica e Jehudëve dhe mushrikëve të

tjer si ata nuk u është ngritur argumenti Allahut ndaj tyre. Kadi 'Ijadi thotë:“Kush e ka këtë mendim është kafir me konsesusin/ixhmanë e muslimanëve.(Esh-Shifa,2/602-603)

Thënia e Xhahizit është e njejt me besimin e atyre që i arsyetojn mushrikët që përshkruhen Islamit duke thënë se jan injorantë dhe se argumenti nuk u është ngritur edhe pse ata veprojn vepra të kufrit dhe shirkut dhe thonë se Allahu dhe Pejgamberi nuk i bëjn tekfir për arsye se nuk ju është ngritur argument. I Lartë Madhëruar qoftë Allahu! Me sa po shohim këta i kanë zemrat dhe dyshimet e njejta!A duhet që të presim që Allahu t'ju dërgoj Pejgamber apo leshoj Melek që t'ua ngrit argumentin dhe ti mësoj?!Thuaj:”Allahu i ka gjithë argumentet ,dhe nëse ai dëshiron,gjithë juve ju kishte udhëzuar!”(El-En;am:149.)

Abu Al Husein Muhammed b. Ahmed Al Akalani al Malati (vdiq 377 pashixhres) ka thënë: ”Dhe kjo përshkak së Mu'tezilëve të Bagdadit dhe Basras dhe krejt ehlu kibla ( të gjithë muslimanët) janë të pajtimit në atë se secili i cili dyshon në kufrin e kafirit,është kafir, për arsye se ai i cili dyshon në kufrin nuk ka iman, dhe ai nuk mund ta bëj dallimin ndërmjet imanit dhe kufrit. Për këtë arsye nuk ka divergjencë(mospërputhje) mendimesh (ihtilaf) në tërë ummetin, bile në këtë pikë nuk janë ndarë as Mu'tezilët dhe të tjerët, pra janë të një mendimi se ai i cili dyshon në kufrin e kafirit është kafir...

28 Et Tanbih var-Radd, f. 40-41

Thotë Shejh Muhammed ibn 'Abdulvehab:“Ajo e cila na bëhet e qartë është Ridja (felëshimi) i tyre.Ndarja e murtedit në riden e tyre ,ka pasur prej tyre që kanë përgenjeshtruar fjalët e Pejgamberit alejhi selam duke thënë: po të kishte qenë Pejgamber nuk do të kishte Vdekur dhe ata i'u kthyen adhurimit të putave dhe zotave rrejshëm! Poashtu ka pasur edhe prej atyre që kanë qëndruar në shehadet,por kanë pohuar Pejgamberin e Musejlemes dhei kanë besuar duke menduar se Pejgamberi alejhi selam e ka marë ortak Musejlemen në shpallje ,për arsye se Musejleme ka ardhur me dëshmi rrejshme. Dhe i kanë besuar një numër i madh prej njerëzve.Për këtë dijetarët janë pajtuar rreth kufrit tyre edhe nëse ata kanë qenë injorantë. Kafir është konsideruar ai qka ka dyshu kufrin e tyre .(Medxhmu'atu et-tevhid)

Shejh Muhammed ibn Abdulwahabi (Allahu e mëshiroftë) thotë: ”Sa mirë që është shprehur një beduin i cili na erdhi në vizitë dhe mësoi diçka nga Islami. Tha: ”Unë dëshmoj se ne jemi kafira, (ai dhe të gjithë banorët beduinë) poashtu ai nga dijetarët i cili neve na ka quajtur muslimanë edhe ai është kafir, salavati dhe selami qoftë mbi Muhammedin .”

108 Ed-Durerus-Senijeh, V. 8/119

Thotë Sheikh Sulejman ibn Sahman (Allahu e meshiroftë) në letrën e tij "Përgjigje rreth tekfirit mbi kafirin":

"Kjo çështje – e kam për qellim – tekfirin e atij që nuk e bënë tekfir kafirin, rreth kësaj të gjithë dijetarët janë pajtuar dhe pajtueshmëria (ixhmaja) e Ulemave është argument të cilit duhet t'i kthehemi. Dhe këto nuk janë vetëm fjalët e sheikhu-I-Islam Muhammed ibn AbdilVehhab. Disa dijetar kanë cekur se anuluesit e islamit janë mbi 400 anulues, por rreth ketyre 10 anuluesve që i ka cekur sheikhu të gjithë dijetarët janë pajtuar, dhe nuk janë prej çështjeve degëzore (furu') që mund të jenë prej çështjeve të fshehta, por tekfiri i kafirit është prej çështjeve të bazave (masaail al-Usul) ku nuk kerkohet arsyetim me padituri (xhehl), dhe askush nuk ka arsyetim nëse e lëshon të punuarit (vepruarit) më këtë (tekfirin e kafirit), pasi që kjo është prej çështjeve më të detyrueshme dhe prej bazave (usul). Nëse e ke kuptuar këtë çështje, atëherë dije se fjala e sinqeritetit (kelimetu-l-ikhlaas – La ilahe il-laAlla) nuk i bënë dobi atij që e shqipton atë (dëshmi) përveçse nëse i drejtohet me sinqertet në adhurim vetem ndaj Allahut Një të vetëm (të paster nga shirku), dhe lëshimi i adhurimit drejtuar dikujt tjetër pos Atij, dhe me mohimin (distancimin – baraa') prej shirkut dhe pasuesve të tij (ehlu-shirk).

Keshtuqë, secili që nuk e bëne tekfir atë që adhuron dikë tjetër krahas Allahut, dhe nuk e mohon atë (baraa') i tilli nuk është musliman në të vertetë, dhe këtij nuk i bënë dobi fjala La ilahe il-laAllah, dhe adhurimi ndaj Allahut me sinqeritet në të gjitha llojet e adhurimeve. Tekfiri mbi atë që e lë (adhurimin me sinqeritet ndaj Allahut), dhe mohimi i shirkut dhe pasuesve të tij (ehlu-shirk), dhe tekfiri mbi atë që e vepron shirkun, kjo është prej Aslu-dini-I-Islam (Baza e fesë Islame) mbi të cilën bazohet (ndërtohet Islami).

Me të vërtetë Allahu i ka quajtur dhe emërtuar pasuesit e shirkut me kufër në shumë ajete që nuk mund të numërohen, keshtuqë partjeter duhet të bëhet edhe tekfiri mbi këta, sepse kjo është nga kushtet dhe nevojat e La ilahe il-laAllah - fjala e sinqeritetit (kelimetu-l-ikhlaas) dhe nuk është i plotë kuptimi i kesaj fjale përpos me

tekfirin mbi atë që

i benë shirk Allahut të Madhëruar në adhurim, ashtu siç ceket në hadithin: "Kush thotë La ilahe il-laAllah, dhe bënë

mosbesim në gjithqka që adhurohet krahas Allahut....". Këtu pra është perforcimi i mohimit (të shirkut të madh dhe

pasuesve të tij), dhe nuk janë të mbrojtura gjaku dhe pasuria përpos me këtë. Keshtuqë ai që dyshon ose ngurron

(heziton) nuk e ka të mbrojtur gjakun dhe pasurinë, siç e ka cekur edhe sheikhu-l-Islam Muhammed ibn AbdilVahhab

(Allahu e meshiroftë) në çështjet e lidhura me këtë hadith.

Dhe ka spjeguar (sheikhu-l-Islam) - Allahu e meshiroftë – se secili që dyshon ose heziton në tekfirin ndaj atij

që nuk e ka mohuar gjithqka që adhurohet krahas Allahut, i tilli nuk e ka të mbrojtur pasurinë dhe gjakun,

e si është atëherë gjëndja e atij që nuk e bënë tekfir kafirin?

Prej çështjeve domosdoshmerisht të njohura prej fesë islame (ma'lum bi-darurah min din al-islam) është se

ai që nuk i benë tekfir kafirat të cilët adhurojnë dikë tjetër krahas Allahut, dhe që i përshkruajnë Allahut

shok e partner, i tilli nuk e njeh fenë islame, (feja) e cila e mbron gjakun e atij që është në të (Islam) dhe

që ka hyrë në të (Islam) dhe që e mbron pasurinë e tij.. Dhe (ai që nuk benë tekfir) nuk e njeh kufrin i cili e bënë

të lejuar pasurin e tij. Allahu na ndihmoftë!"

Burimi Exhvibeh fi takfir al kafir faqe1

Thotë shejh Abdullah ibn Abdurrahman ibn Ebu Batin:"Atij që I ka aritur thirrja e Pejgamberit alejhi selam dhe te ai që ka arituri Kur'ani i është ngritur argumenti dhe nuk do të arsyetohet për arsye nëse ai nuk beson në Allahun në Melaiket e Tij, në Librat ,Pejgambert dhe Ditën e Gjykimit,ngase pas kësaj nuk ka arsyetim me injorancë.Allahu Subhaneh ,na ka informuar për injorancën e shumë pabesimtarëve dhe qartë na ka treguar për mosbesimin e tyre .I përshkruan Krishterët si injorantë dhe muslimani nuk dyshon kufrin e tyre dhe padyshim se shumica e Krishterve dhe Jehudve janë injorantë dhe pasues qorazi. Ne jemi të bindur në



kufirin e tyre dhe në kufirin e atij çka dyshon kufirin e tyre." Thotë shejh Ebu Batin Allahu i Lartëmadhërihëm e Mëshiroft:"Muslimanët janë pajtuar rreth kufirit e atij i cili nuk i bën tekfir Krishterët dhe Jehudët ,apo dyshon në kufirin e tyre , ndërsa ne jemi të bindur se shumica e tyre janë Injorantë.

"Medxhmu'atu er-resailvel-mesail en-Nedxhdijje", 1/659

Është pyetur Sheikh Abdullah b. Abdulatif (Allahu e mëshiroftë):"...për atë i cili nuk e shpallë kafir shtetin (turk) dhe i ndërsen (nxit) ata kundër muslimanëve, duke zgjedhur vilajetin (pushtetin) e tyre dhe se xihadi me ta (ndihmesa ndaj tyre) është e domosdoshme. Dhe për personin e dytë i cili nuk mendon ashtu, përkundrazi shteti dhe ata që i ndërsejnë (nxisin) janë zullumqarë dhe prej tyre nuk është e lejuar vetëm se ajo çka është e lejuar prej zullumqarëve dhe plaçka e marrë nga beduinët është haram? Sheikhu është përgjigjur:"Kush nuk e di kufirin e shtetit (turk) dhe nuk bënë dallimin mes tyre dhe zullumqarëve mes muslimanëve - nuk e ka kuptuar domethënien e 'La ilahe il-la Allah'. Nëse gjatë kësaj beson se ai është shtet musliman - atëherë kjo është e keqe edhe më e madhe. Dhe kjo do të thotë të dyshosh mbi kufirin e atij që ka bërë mosbesim në Allahun dhe i cili i ka bërë shirk Atij. Nëse edhe i ndërsen (nxit) dhe u ndihmon kundër muslimanëve me çfarëdo qoftë lloj ndihme - pa dyshim se kjo është rid'et i hapur (felëshim)".

(Ed-Durer Es-Senijeh,8/42)

Dy djemtë e Muhammed b. Abdul-Vehhabit, Husejn dhe Abdullah (Allahu i mëshiroftë të gjithë) kanë thënë:Kush thotë: "Unë kundër mushrikëve nuk do të kem armiqësi" ose, ka armiqësi kundër tyre, por nuk i shpallë kafira, ose thotë: "Nuk kam asgjë kundër atyre që thonë 'La ilahe il-la Allah', edhe nëse bëjnë kufër dhe shirk; ose nëse kanë armiqësi kundër fesë së Allahut" ose "Nuk jam kundër atyre që i luten varrezave" atëherë ai person nuk është musliman! Ai është ndër ata për të cilët Allahu thotë:"Sigurisht, ata të cilët nuk besojnë Allahun dhe të Dërguarit e Tij dhe që duan të bëjnë dallime mes besimit në Allahun dhe në të Dërguarit e Tij duke thënë: "Ne besojmë disa prej tyre, por i mohojmë të tjerët" dhe që duan të bëjnë për vete një rrugë të ndërmjetme, Këta në të vërtetë janë mosbesimtarë dhe për mohuesit Ne kemi përgatitur ndëshkim poshtërues." (An Nisa 150-151) Pra, Allahu na ka detyruar që kundër mushrikëve të kemi armiqësi, të sillemi ashpër me ta dhe t'i konsiderojmë pabesimatarë (kafira).

(Medxhmu'atu et-Tevhid,faqe 284. Shih :Ed-Dureru Es-senijeh,8/111)

Shejh Mahmud Shukri Al Alushi ka thënë:"Kush i thotëmushrikut musliman ai ka nevoj për mjekim të mendjes para se ti ngritet ndonje argument " [Ghayat al-Amani fi al-Radd 'ala al-Nabhani (1/54)]

Shejh Abdullah dhe shejh Ibrahim ,djemt e shejh AbduLatifit ,dhe shejh Sulejman ibn Sehmanit në përgjigjen rreth pyetjes rreth tekfirit xhehmijve dhe adhuruesve varreve kanë thane:"Nuk është i sakt imamlleku i atij që nuk i bën tekfirë Xhehmitë dhe Kuburijunët(adhuruesit e varreve), apo dyshon në kufrin e tyre, dhe kjo çështje është prej më të qartave tek nxënësit e dijes dhe pasuesit etransmetimeve (hadithit).Sa i përket Kuburijinëve (adhuruesve të varrezave), nuk dyshon në kufrin e tyre ai që e ka ndijerë erën e Imanit." (Ed-Dureru Es-Senijje,10/436)

Ka ardhur në "Ed-Dureru Es-Senijje",në vëllimin e dytë faqe 176 :”Dijetarët Islam janë pajtuar se ai i cili nuk i bën tekfir mushrikët apo dyshon kufrin e tyre apo e konsideron medhehbin e tyre të saktë dhe e beson se udhëzimi i tyre është më i mire se udhëzimi Allahut dhe të Derguarit të Tij ose uren diçka me të cilën ka ardhur Pejgamberi alejhi selam edhe nëse vepron sipas asaj, ai është kafir për arsye se nuk është nënshtruar Allahut plotësisht.”

Shejh Abdullah djali i shejhut Muhammed bin Abdulvehabit,Allahu i mëshiroft të dy ,në shpjegimin e fjalimit të Ibnul-Kajjimit Allahu i mëshiroft në kaptinën e pendimit thotë:”Ty të është bërë e qartë se Islami yt nuk do të jetë i saktë vetëm se me armiqtësimin e mushrikëve, nëse nuk i armiqtëson do të jesh sikur ata edhe nëse nuk vepron atë që ata e veprojnë.” (Medxhmu’atu Et-Tevhid,faqe.35.)

Ulemat e Nexhdit kanë thënë:“Çështja e dytë: Nga ajo që pas vetes tërheq domosdoshmërinë e xhihadit kundër atij i cili është përshkruar me të, është mostekfiri i mushrikëve ose dyshimi në kufrin e tyre sepse kjo bie në çështjet të cilat e shkatërrojnë Islamin (La ilahe il-la Allah). Prej këtui, kush përshkruhet me këtë – bëhet kafir dhe gjaku i tij është hallall poashtu edhe pasuria e tij, kurse lufta ndaj tij është vaxhib, derisa nuk fillon që t’i bënë tekfir mushrikët. Argument për këtë janë fjalët e Muhammedit i cili thotë: ”Kush thotë 'La ilahe il-la Allah', dhe pastaj bënë kufër mbi secilin që adhurohet përskaj Allahut - gjaku dhe pasuria e tij janë të mbrojtur.” Këtui mbrojtja e gjakut dhe pasurisë lidhen me dy gjëra: E para: Thënia e fjalës ”La ilahe il-la Allah”. E dyta: Të bërit kufër në gjithçka që adhurohet përskaj Allahut. Pra, nuk do të jetë gjaku dhe pasuria e një personi e mbrojtur derisa ky person nuk vjen me dy gjëra: 1. E para: Thënia e fjalës 'La ilahe il-la Allah', kurse me këtë obligohet domethënia e kësaj, e kursesi jo vetëm thënia e saj si frazë (fjalë) pa kuptim, kurse domethënia e saj është Teuhidullah me të gjitha llojet e ibadeteve. 2. E dyta: Të bërit kufër mbi çdo gjë që adhurohet përveç Allahut, me këtë nënkuptohet të bërit tekfir mbi mushrikët, distancim nga ata dhe nga çdo vepër tjetër të cilën ata ia kushtojnë dikujt tjetër përskaj Allahut. Dhe prej këtui kush nuk i bënë tekfir mushrikët e shtetit Turk dhe adhuruesit e varreve, sikur janë edhe banorët e Mekkes dhe të tjerë që adhurojnë njerëz të mirë dhe që kanë devijuar nga Teuhidi i Allahut duke rënë në shirk dhe të

cilët e kanë ndërruar sunnetin e të Dërguarit të Tij me risira (bid`ate) - i këtili është kafir sikur ata edhe pse e urren Dinin (fenë e tyre) kurse e do Islamin dhe muslimanët.”

(Ed Dureru Es-Senijje,9/291)

Është detyrë që cdo musliman që sheh shirk të qartë të besojë se ky është shirk dhe se bërësi i saj është qafir sikurse tha imam Berbehari: “E nëse dikush vepron ndonjë gjë prej këtyre (dmth: bën shirk me të gjitha format e tij) atëherë obligohet (dhe është detyrë) mbi ty që ta nxjerrësh atë nga islami..”(sherh es Suneh). Imam Berbehari

Ulemat e Nexhdit Allahu i mëshiroft kanë thënë:"Ai i cili nuk i bën Tekfir mushrikët nuk beson në Ku'ran, për shkak se Ku'rani flet dhe i bën tekfir mushrikët dhe ka ardhur urdhëri në Kuran për Tekfirin e mushrikve, të armiqsohen dhe ndaj tyre të bëhet luftë/xhihad ." (Ed-Dureru Es-Senijje, 9/291)

Thotë Sulejman ibn Sahman (Allahu e meshiroftë): "E sa i përket xhehmijeve dhe u'bbad el kubur (adhuruesit e varrezave), nuk ka mospajtim te dijetarët rreth tekfirit mbi këta.." Thotë Sulejman Ibn Sahman (Allahu e meshiroftë): "Nuk kemi parë mosmarrveshje mbi tekfirin e atyre që nuk i bëjnë tekfir xhehmijet". Thotë AbdulLatif (Allahu e mëshiroftë): "Nuk kam parë asnjë prej dijetarëve (tek i cili kthehesh për të kërkuar dituri) që ka dyshuar në kufrin e ubbad al Kubbur."

(Keshful-evham vel-iltibas,faqe 76)

Ka thene shejh Sulejman bin Sehman :”Pergjigja eshte se ai që nuk i bën tekfir mushrikët apo dyshon kufrin e tyre është kafir .Kjo është e vertetadhe ky është besimi i ehli sunnetit dhe xhematit .”

(Keshful-evham vel iltibas,faqe 72.)

Thotë Sheikhu i nderuar Ebu Betin Abdullah ibn Abdur-Rahman(Allahu e mëshiroftë):"Dijetarët e të gjithë shkollave juridike (medh´hebeve) kanë cekur shumë gjëra të cilat nuk mund t'i numërojmë që janë nga fjalët, veprat dhe bindjet, vepruesit e të cilëve bëhen mosbesimtarë (kafira) dhe këtë nuk e kanë kufizuar vetëm tek inatçiu. Për këtë shkak, secili që thotë se vepruesi i kufrit mundet të arsyetohet me te´vil (keqkuptim), ixhtihad (ai që përpiqet të gjej ndonjë rregull sheriatike dhe pastaj gabon), pasim qorrazi (taklid) ose nga mosdituria (injanca, xhehli) – i është kundërvënë librit,sunnetit dhe ixhmasë, pa kurrfar dyshimiAi që thotë kështu, duhet domosdoshmërisht ta shkatëroj këtë themel të gabuar.Sepse nëse deri në fund i përmbahet këtij qëndrimi - pa dyshim do të bëhet mosbesimtar (do ta humb emrin ose statusin si musliman dhe e marrë emrin kafir, që pastaj kjo në vetvete tërhek edhe dënimin), kjo i ngjanë shembullit të atij personi që dyshon në shpalljen e Muhammedit...pastaj vazhdon sheikhu dhe thotë:"Nëse vepruesi i shirkut të madh arsyetohet me padituri (injanca, xhehl)atëherë kush mbetet që të thotë se nuk ka arsyetim?... Sipas këtij pohimidel se Allahu

mbi asnjërin nuk ka argument përveç mbi inatçin. Thënësi i këtij pohimi nuk do të jetë në gjendje t'i përmbahet këtij themeli. Përkundrazi, ai domosdo do të bie në kundërshtime. Sepse nuk guxon të përmbahet mbi tekfirin e atij që dyshon në shpalljen e Muhammedit ose që dyshon në ringjalljen ose në gjërat tjera nga themeli i fesë (Aslu Din). Kurse ai që dyshon është i paditur, injorant... deri te fjalët ...prej kësaj rezulton se nuk guxojmë ti bëjmë tekfir të paditurit nga çifutët, krishterët dhe ata që i bëjnë sexhde Diellit, Hënës dhe statujave, përshkak të paditurisë (injurancës, xhehlit), as ata që i ka djegur Ali Ibn Ebi Talib , sepse jemi të bindur se ata kanë qenë të paditur. Kurse të gjithë muslimanët janë pajtuar se pabesimtar është ai i cili nuk bënë tekfir mbi Çifutët, Krishterët ose dyshon në mosbesimin e tyre, kurse ne jemi të bindur se shumica e tyre janë të e paditur.”Të Gjitha këto vepra të përmendura e prishin themelin e dinit Islam 'La ilahe il-la Allah', dhe askush prej muslimanëve nuk dyshon në këtë dhe nuk i kanë arsyetuar në këto mesele. (Ed Durerus- Senijeh, V. 12/69-74) Ka thënë shejh Abdurrahman ibn Hasan ,Allahu e mëshiroft :”Përmendet ne “Sunnen” se Abdullah iben Mesudi radijallahuanhu i ka bërë tekfir ata të cilët ishin në xhami në kufe për arsye se njëri ka thënë:”Me të vërtetë Musejleme është në hak,kur ai i ka thënë këto fjalë të tjerët kanë heshtur,për këtë Abdullah ibn Mesudi dha fetva se të gjithë janë në kufr.Nga kjo kuptojm se njeriu nuk është i sigurt që kur ti shqiptojë fjalët e kufrit apo i ndëgjon dhe hesht .Per atë bëhuni të kujdesshëm ju që keni mendje ,nxitoni për pendim për arsye se fitneja ka ndodhur në ASLLU DIN (bazë të fesë) dhe jo jashtë suazave të Asllu Dinit apo ç’ështëjeve dynjas.” (Ed Dureru Es-Senijje,27/127.)

Thote shejh Abdurrahman ibn Hasan Alu esh-Shejh në shpjegimin e risales “Asllu Din (themeli) il Islam dhe shtyllen e tij e përbejn dy gjera nga gjyshi i tij Muhammed ibn Abdulvehab:”Ai i cili nuk e bënë tekfir atë që Kur’ani e ka bërë tekfir –ky person i ka kundërshtuar të gjithë Pejgamberët që erdhën me thirrjen në Teuhid.” (Medxhmu’atut-Tewhid)

Perktheu nga arabishtja Mithat Kalendar

Perktheu prej gjuhës boshnjake në gjuhën shqipe Ridvan Memishi